



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 206 prot.

Tiranë, më 07 . 02 . 2019

Lënda: Rekomandim për përmirësimin e kuadrit ligjor me qëllim njohjen e periudhës së shërbimit si kujdestar i personit me aftësi të kufizuar, si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor, në baza të barabarta për të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Adresa : Rruga e Kavajës, Tiranë

Për dijeni:

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Adresa : Rruga “Bogdani” (ish-A.Z.Çajupi) Nr. 15, Kati III, Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si institucion i pavarur publik, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”. Në përmbushje të qëllimit të

Adresa: Rruga “Durrësit” (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

ligjit 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri), parashtron sa më poshtë vijon:

I. Hyrje

1. Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur informacion nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), sipas të cilit ka një diferencë në trajtim midis kujdestarëve të personave që kanë statusin e personit të verbër dhe kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara që kanë statusin e invalidit paraplegjik/tetraplegjik. FSHDPAK shpjegon se, parashikimet ligjore ekzistuese u njohin kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara që kanë statusin e personit paraplegjik/tetraplegjik, të drejtën që periudha e shërbimit si kujdestar t’u njihet si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Baza ligjore që iu garanton këtë të drejtë kujdestarëve të personave paraplegjike dhe tetraplegjik janë: VKM nr. 328, 12.03.2009, “Për disa shtesa në vendimin nr. 618, datë 07.09.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar dhe VKM nr. 326, datë 12.03.2009 “Për disa shtesa në vendimin nr. 31, datë 20.01.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.
2. Nga ana tjetër, periudha e shërbimit si kujdestar për personat që kanë statusin e personit të verbër, nuk njihet si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. FSHDPAK shprehet se, nuk ka asnjë ndryshim ndërmjet detyrimeve ligjore për shërbimin e kujdestarisë për personat me statusin e invalidit paraplegjik/tetraplegjik dhe shërbimit të kujdestarisë për personat me statusin e të verbërit. Përfashtimi i kujdestarëve të personave me statusin e të verbërit nga vlerësimi si periudhë sigurimi kohën e shërbimit të kujdestarisë dhe njohja e kësaj të drejte vetëm për kujdestarëve të personave paraplegjik/tetraplegjik, sjell një situatë të padrejtë dhe diskriminuese.
3. Sa më sipër kërkohet përmirësimi i kuadrit ligjor me qëllim njohjen e periudhës së shërbimit të kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara që kanë statusin e personit të verbër, si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor.

II. Legjislacioni i zbatueshëm

Sa më lart, në kuadër të trajtimit të kësaj problematike, Komisioneri analizoi gjithë legjislacionin përkatës, që rregullon shërbimin e kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara:

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹

Neni 4

Detyrime të përgjithshme

Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.

Asgjë nga kjo konventë nuk duhet të prekë ato dispozita që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe që mund të përmbahen në ligjin e shtetit palë apo të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë shtet. Nuk duhet të ketë asnjë kufizim apo cenim të asnjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njohura apo ekzistuese në cilindo shtet palë në këtë konventë në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret apo zakonet me pretekstin se kjo konventë nuk i njeh këto të drejta apo liri apo se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

Neni 3

Përkufizime

“Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

¹Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Neni 8

Ndihmësi personal

Ndihmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe në të dëgjuar.

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 3

Përkufizimet

"Diskriminim për shkak të shoqërimit" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

Neni 20

Të mirat dhe shërbimet

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:
 - a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:
 - c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve,

përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Neni 58

Periudha e sigurimit

1. Periudhat e sigurimit përfshijnë të gjitha periudhat:
 - a) për të cilat janë paguar kontributet;
 - b) gjatë të cilave është bërë pagesa nga sigurimet shoqërore, përfshirë edhe periudhën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.
2. Këshilli i Ministrave mund të deklarojë edhe periudha të tjera si periudha të sigurimit, duke u derdhur kontributi në fondin e sigurimit shoqëror nga Buxheti i Shtetit.

Ligji Nr.10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”

Neni 5

Personat e Siguruar

2. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e mëposhtme të personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj:
 - a) personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
 - b) personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - c) personat e regjistruar si të papunë-punëkërkues në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
 - ç) shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë;
 - d) fëmijët nën moshën 18 vjeç;
 - dh) nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike;
 - e) kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta.

Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar

Neni 4

31. “Kujdestar me pagesë” është personi i caktuar për t’u kujdesur për personin me aftësi të kufizuara, që ofron shërbim për të në veprimtarinë e përditshme, në shtëpi, në udhëtim, në punë, në shkollë dhe në veprimtaritë shoqërore.”

Vendimi nr.326, datë 12.3.2009 “Për disa shtesa në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar”

Periodha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor. Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohet nga Buxheti i Shtetit.

Vendimi nr.328, datë 12.3.2009 “Për disa shtesa në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar”.

Periodha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe përballohet nga buxheti i shtetit.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 431, datë 8.6.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, i ndryshuar.

Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmës personal, gjithëpërfshirëse apo të herëpashershme, përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Ndihmësit personalë përzgjidhen nga përfituesit, kujdestari ligjor/prindi ose përmes procesit të vendimmarrjes së mbështetur dhe mund të ofrohen nga anëtarë të familjes, të afërm të përfituesit ose familjes, përfaqësues ligjorë ose agjenci të specializuara, të regjistruara dhe të licencuara.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar.

I. Kriteret dhe grupet, që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar

1. Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Personat, paraplegjikë e tetraplegjikë, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkak dhe mosha, përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.
3. Personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të cilët, me vendim të komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

III. Analiza ligjore

4. Rezulton se aktualisht është duke u pilotuar modeli i vlerësimit biopsikosocial i aftësisë së kufizuar, nëpërmjet Komisioneve Shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Sipas VKM nr. 431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, ky model është duke u zbatuar në Njësitë Administrative Nr. 6 dhe Nr.7 të Qarkut Tiranë. Ky model është duke u zbatuar në një territor administrativ të kufizuar, për një peiudhë kohore të kufizuar (aktualisht afati hohor është deri në 31.12.2019), por përmban kufizime në zbatim edhe për sa i përket subjekteve tek të cilët shtrin zbatimin e tij. (përgjashtimet sipas pikës 1, të Kreut VI, të VKM nr. 431 datë 08.06.2016, të ndryshuar). Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat nuk do të kryhet pilotimi, do të zbatohet legjislacioni në fuqi për aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore (neni 42 i ligjit nr. 9355/2005, i ndryshuar). Pra, rezulton se janë duke u zbatuar dy modele të ndryshme të vlerësimit të aftësisë së

kufizuar. Në këtë rekomandim, Komisioneri ka marrë në analizë vetëm legjislacionin në fuqi për aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore dhe jo modelin e ri biopsikosocial të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili është duke u pilotuar sipas VKM nr. 431/2006 të ndryshuar.

5. Referuar legjislacionit në fuqi për aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore, parashikohet e drejta e personave me aftësi të kufizuara për të patur një kujdestar me pagesë. Rezulton nga aktet nënligjore në fuqi (VKM nr.618/07.09.2006, i ndryshuar) se, e drejta për të patur kujdestar me pagesë për personat me aftësitë të kufizuara përcaktohet me vendim të Komisioneve Mjekësore të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Pra, nëse KMCAP vlerëson se personi me aftësi të kufizuar ka nevojë për përkujdesje, ai përfiton të drejtën për të patur kujdestar me pagesë.
6. I njëjti rregullim parashikohet edhe në ligjet dhe aktet nënligjore të posaçme që rregullojnë çështjet e personave me statusin e personit paraplegjikë/tetraplegjikë (ligji nr. 8626/22.06.2000 “Statusi i Invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, VKM nr. 31, datë 20.01.2001) dhe çështjet e personave që kanë statusin e personit të verbër (Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 277, datë 18.06.1997, të ndryshuar). Të dy këto kategori personash me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të kenë kujdestar me pagesë, sipas kushtevë të përcaktuara dhe kjo e drejtë përcaktohet me vendim të KMCAP-së për personat paraplegjikë/tetraplegjik dhe nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Verbërisë (KMCAV-ja).
7. Po çfarë kuptojmë me termin “kujdestar me pagesë”? Një përkufizim për kujdestarin me pagesë jepet nga Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i cili në nenin 4, pika 31, parashikon se kujdestari me pagesë është personi i caktuar për t’u kujdesur për personin me aftësi të kufizuara, që ofron shërbim për të në veprimtarinë e përditshme, në shtëpi, në udhëtim, në punë, në shkollë dhe në veprimtaritë shoqërore. Ndërsa ligjet respektive për statusin e personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe aktet nënligjore respektive që kanë dalë në zbatim të tyre, nuk përmbajnë ndonjë parashikim në lidhje me konceptin e kujdestarit. Ajo që është e përbashkët në legjislacionin që rregullon aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë këtu edhe ligjet për statuset respektive, është se nevoja për kujdestar përcaktohet nga KMCAP/KMCAV. Sipas legjislacionit në fuqi nuk ka asnjë ndryshim midis shërbimit të kujdestarisë për personat me statusin e personit të verbër dhe shërbimit të kujdestarisë për personat me statusin e të verbërit.
8. Rezulton se, me vendimin nr.326, datë 12.3.2009 “Për disa shtesa në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar”, dhe vendimin nr.328, datë 12.3.2009 “Për

disa shtesa në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar", është parashikuar që periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor. Nëpërmjet këtij parashikimi ligjor kujdestarëve të personave me statusin e paraplegjikut dhe tetraplegjikut i'u është njohur një e drejtë për të përfituar nga skema e sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i detyrueshëm shëndetësor. Kjo e drejtë nuk i'u njihet kujdestarëve të personave të verbër, edhe pse rezulton se ata ndodhen në kushte të njëjta me kategorinë e kujdestarëve të personave që kanë statusin e personit paraplegjik dhe tetraplegjik.

9. Ligji nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke ndaluar refuzimin për të përfituar nga skema e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë sigurimet shoqërore, përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, apo përfitimin nga çdo skemë tjetër e mbrojtjes sociale të ndonjë personi ose grupi personash. Në rastin konkret, ndodhemi në kushtet kur personat, të cilët shërbejnë si kujdestarë të personave me statusin e të verbërit, i'u mohohet e drejta për të përfituar nga skema e mbrojtjes shoqërore duke mos i'u njohur si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor, periudha që ata shërbejnë si kujdestarë të personave të verbër. Në këto kushte rezulton se personat që shërbejnë si kujdestarë të personave me statusin e të verbërëve, edhe pse të ndodhur në kushte të njëjta me personat që shërbejnë si kujdestarë të personave me statusin e personit paraplegjik tetraplegjik, nuk gëzojnë në baza të barabartë të drejtën për të përfituar nga skema e mbrojtjes shoqërore. Në kushtet kur nuk rezulton asnjë justifikim objektiv dhe i arsyeshëm, dallimi që i bëhet kujdestarëve të personave me statusin e të verbërit, në krahasim me kujdestarët e personave me statusin e paraplegjikut/tetraplegjikut, përbën diskriminim sipas ligjit nr. 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*".
10. Por, a gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi sipas Ligjit nr. 10221/2010, personat që shërbejnë si kujdestarë të personave me aftësi të kufizuar, edhe pse ata nuk janë persona me aftësi të kufizuar, pra nuk kanë shkakun e aftësisë së kufizuar, i cili është një shkak i mbrojtur nga Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"? Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë në parashikimin që bën neni 3, pika 4, e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku sanksionohet se diskriminimi ndodh edhe kur kemi një dallim, kufizim apo preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të mbrojtura nga neni 1, i ligjit, por edhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë. Kujdestarët e personave me statusin e të verbërit gëzojnë mbrojtje nga dispozitat e Ligjit Për mbrojtjen nga

diskriminimi, për arsye të shoqërimit me personat me aftësisë të kufizuara, të cilëve ata u shërbejnë, pra për shkak të lidhjes së ngushtë që ata kanë me personat me aftësi të kufizuara.

11. Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Konventa ka pranuar se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët. Ky përcaktim synon gjithpërfshirjen dhe jo përjashtimin. Në përputhje me Konventën, edhe Ligji Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë, ka si bazë gjithpërfshirjen e aftësisë së kufizuar dhe diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, një nga parimet themelore të kësaj konvente është parimi i mosdiskriminimit. Ky parim ka të bëjë jo vetëm me mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në raport me personat e tjerë, por edhe brenda kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.
12. Sipas legjislacionit në fuqi rezulton se, të drejtën për të përfituar shërbimet e një kujdestari me pagesë përveç personave me statusin e të verbërit dhe ata me statusin e paraplegjikut dhe tetraplegjikut, e kanë të gjithë personat, të cilëve u është kufizuar aftësia si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psiko/mendore, të lidura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga KMCPA, i cili ka përcaktuar gjithashtu se personi me aftësi të kufizuar ka nevojë për përkujdesje. Bazuar në analizën e bërë më sipër në lidhje me situatën e kujdestarëve të personave me statusin e të verbërit, konstatohet se edhe kujdestarët e personave të tjerë me aftësi të kufizuara, nuk i'u njihet periudha e shërbimit si kujdestar i personit me aftësi të kufizuar, si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor, duke u trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar.

IV. Konkluzione

13. Sa më sipër, Komisioneri konstaton se, kujdestarët e personave me aftësi të kufizuar gëzojnë mbrojtje sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si pasojë e lidhjes së ngushtë që ata kanë me personat me aftësi të kufizuara të cilëve ata u shërbejnë. Rezultoi një trajtim i diferencuar, midis kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë dhe jo duke u kufizuar vetëm tek kujdestarët e personave me statusin e të verbërit, në raport me kujdestarët e personave me statusin e paraplegjikut/tetraplegjikut. Kjo kategori personash, rezulton se trajtohet në mënyrë më pak të favorshme, pasi nuk i'u

njihet periudha e shërbimit si kujdestar i personit me aftësi të kufizuar, si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor, që legjislacioni në fuqi garanton për grupin e kujdestarëve të personave me statusin e paraplegjikut/tetraplegjikut, edhe pse sipas legjislacionit në fuqi kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat detyrime ligjore. Kjo diferencë në trajtim vjen për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar dhe nuk ka një përligje objektive dhe të arsyeshme.

14. Komisioneri vlerëson se, me qëllim eliminimin e situatës diskriminuese për kategorinë e kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuar, duke përfshirë dhe jo duke u kufizuar vetëm tek kujdestarët e personave me statusin e të verbërit, është e domosdoshme ndërmarrja e iniciativës për plotësimin e legjislacionit, që do të mundësonte që periudha që ata shërbejnë si kujdestarë të personave me aftësi të kufizuara t'iu njihet si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor.
15. Komisioneri dëshiron të sjellë në vëmendje se, edhe pse ka marrë në analizë legjislacionin në fuqi për aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore dhe jo modelin bio-psiko-social, i cili është duke u pilotuar vetëm në Njësitë Administrative Nr.6 dhe Nr.7, të Qarkut të Tiranës, sipas parashikimeve të VKM nr. 431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, parimi dhe e drejta për barazi dhe mosdiskriminim, sa më sipër është trajtuar, duhet të aplikohen edhe në zonat pilot.
16. Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në pikën 12, të tij shprehet se: *“Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime dhe të drejta. Konventa u referohet atyre në nenin 3 si parime dhe në nenin 5 si të drejta. Ato janë gjithashtu një mjet interpretues për të gjitha parimet dhe të drejtat e tjera të mishëruara në Konventë. Parimet/e drejta për barazi dhe mosdiskriminim janë gur themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të garantuar nga Konventa. Promovimi i barazisë dhe trajtimi i diskriminimit janë detyrime ndërsektoriale të realizimit të menjëhershëm. Ato nuk i nënshtrohen realizimit progresiv.”*
17. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, me qëllim eliminimin e situatës diskriminuese, masat duhet të ndërmerren në një kohë sa më të shpejtë,
18. Sa më lart, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

REKOMANDON

- Marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për plotësimin e legjislacionit, me qëllim njohjen e periudhës së shërbimit si kujdestar i personit me aftësi të kufizuar, si periudhë sigurimi për efekt pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor, në baza të barabarta për të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.

Lutemi përcjelljen e informacionit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi dhe zgjidhjen e situatës apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA